



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT DHE E SHKENCËS
AGJENCIA KOMBËTARE E PROVIMEVE

PROVIMI I LIRIMIT

SESIONI I

E mërkurë, 12 qershor 2013

Ora 10.00

Lënda : Gjuhë shqipe

Udhëzime për nxënësin

Testi në total ka **25 pyetje**.

Trembëdhjetë pyetje janë me qarkim.

Dymbëdhjetë pyetje janë me zhvillim.

Përgjigjet e të gjitha pyetjeve do të shkruhen në **fletore**.

Për pyetjet me alternativa do të shkruani në **fletore** numrin e pyetjes dhe shkronjën që i përgjigjet alternativës së saktë.

Për pyetjet me shtjellim do të shkruani numrin e pyetjes dhe poshtë saj të gjithë përgjigjen që do të jepni.

Pikët për secilën pyetje janë dhënë përbri saj.

Koha për zhvillimin e kërkesave të testit është 2 orë e 30 minuta.

PJESA I

Ja si u bëra tregimtar

Lexoni pjesën e mëposhtme, pastaj përgjigjuni pyetjeve që vijojnë.

Unë jam nga jugu, ndaj që në fëmijëri e ndieja se do të bëhesha tregimtar. Që herën e parë, kur dëgjova një histori, madje shumë kohë para se të mësoja të lexoja, e dija se do të dëshiroja të rrëfeja edhe vetë. Unë vij nga një familje ku televizori shuhet kur dikush është duke rrëfyer diçka në verandë. Historitë ishin ndodhi që ma tërhiqnin gjithnjë kureshtjen. Familja jonë përbëhej nga pesë fëmijë, mamaja dhe babai, madje dhe gjyshja, e cila jetoi me ne për pak kohë. Ndaj në kohën e drekës, ju e imagjinoni, që të gjithë kërkonin sa më shumë vëmendje. Unë e dija se, nëse do të mund të rrëfeja diçka interesante, mund të isha në qendër të grupit. Historitë ishin diçka shumë e rëndësishme për familjen time, sepse dijet çmoheshin shumë. Jo thjesht libra me informacion, edhe pse familja ime ishte familje lexuesish, por pikërisht njohja e dukurive. Leximi respektohej shumë në shtëpi. Mamanë time do ta gjeje gjithmonë duke lexuar një libër me kapak kartoni në karrigen e saj të madhe me ngjyrë të kuqe dhe nga ne kërkohej që në atë moment të mos e shqetësonim për asnjë arsye. Nuk po flas këtu për revista, oh jo, por për libra me *kapakë kartoni*. Dhe unë isha i vogli i familjes, ai që vraponte tërë kohës rreth e qark duke bërë titur: "Kush më do, kush më do mua!", ndërsa mendoja: "Ç'është ajo gjë kaq e rëndësishme për mamanë, saqë e mban atë larg meje?". Kur ajo ngrihej, duke e lënë librin mbi karrige, unë e merrja dhe e shikoja me kureshtje. Por nuk pashë kurrë ndonjë ilustrim, por vetëm fjalë. Dhe mendoja: "Oh zot, duhet të ketë diçka magjike këtu".

Nuk mbaj mend të kem pyetur ndokënd në lidhje me ndonjë përvojë të tillë, të përafërt. Mendoj se, ndoshta, të shkruarit u kthye në diçka shumë të rëndësishme për brezin tim, sepse prindërit tanë ishin shumë të lidhur me arsimin dhe sigurisht që ai ishte baza mbi të cilin ngriheshin jetët tona.

Ndaj interesimi im për të shkruar ndoshta u shfaq që në shtëpi, me historitë e shkurtra dhe më pas, në mënyrë të natyrshme kaloi te librat. Tashmë historitë vijnë te unë në të gjitha mënyrat e mundshme. Romani im i parë "*Fëmija i familjes*" erdhi te unë pjesë - pjesë. Ai filloi si një histori e shkurtër, për një vajzë të vogël, që jetonte në një qytet provincial, në jug të vendit, e cila shkonte, përmes një rruge tërë pluhur, në një sallon bukurie, pasi i pëlqente shumë të rregullonte flokët. Vajza shkonte shpesh atje, sepse ishte shumë e kujdesshme për pamjen e saj dhe gjyshja me mamanë, meqenëse nuk duronin dot ta shikonin duke qarë, e lejonin të shkonte sa herë të donte.

Njëherë ajo takon atje një grua shumë të bukur, me një lëkurë të zeshkët, të cilën nuk e kishte parë kurrë më parë. Kur gruaja filloi të fliste, vajza kuptoi nga dialekti i saj se ajo nuk ishte nga ai vend, por nga një ishull në det. Më vonë, gruaja e mbështolli vajzën me krahët e saj dhe i mësoi shumë gjëra: si të bëhej një zonjushë e vërtetë, të bënte pyetje, të njihte botën.

Kur e dërgova këtë histori për botim, ma refuzuan disa herë, prandaj u trishtova shumë. Punova sërish me të dhe e ridërgova, por prapë ma refuzuan. Më në fund e kuptova se nuk kisha më një histori të shkurtër. Kisha nevojë të mësoja se kush ishte në të vërtetë vajza e vogël, ku jetonte, çfarë ndodhi kur u kthye në shtëpi, si ishin prindërit e saj, kur shkonte në shkollë. Sapo i mësova këto gjëra rreth saj, historia filloi të bëhej gjithnjë e më e gjerë. E dija se vajza e vogël ishte e veçantë dhe në atë moment e kuptova se duhej të shkruaja një roman.

1. Bazuar në **paragrafin e parë**, çfarë beson autori në lidhje me librat me *kapakë kartoni*? 1 pikë
 - A) Ato ishin një privilegj që u takonte vetëm të rriturve.
 - B) Ato ishin të mërzitshme sepse nuk kishin ilustrime.
 - C) Ato meritonin më tepër respekt se çdo gjë tjetër e shkruar.
 - D) Ato siguronin një burim të mirë frymëzimi për historitë e familjes.

2. Çfarë mësoi autori nga refuzimet që i bënë historisë së shkurtër që dërgoi për botim? 1 pikë
 - A) Historia kishte një subjekt të vështirë për t'u trajtuar.
 - B) Historitë me vajza të vogla nuk i tërheqin shumë të rriturit.
 - C) Historia nuk ishte e plotë kur e shkroi fillimisht.
 - D) Historitë e shkurtra janë më të vështira për t'u shkruar se sa romanet.

3. Çfarë bëri autori për ta kthyer historinë e shkurtër në roman? 1 pikë
 - A) Ndryshoi mjedisin.
 - B) Zhvilloi personazhet.
 - C) E bëri gjuhën më përshkruese.
 - D) Krijoi një përmbajtje më të fokusuar.

4. Duke parë interesin që familja e tij kishte për librin, autori mësoi të vlerësonte: 1 pikë
 - A) rëndësinë e rrëfimit bukur të historive.
 - B) rëndësinë e të qenit më i vogli në familje.
 - C) studimin e autorëve të ndryshëm.
 - D) historitë që rrëfente gjyshja e tij.

5. Në ç'mënyrë fëmijëria e autorit ndikoi në vendimin e tij për t'u bërë shkrimtar? Përdorni ilustrime nga pjesa për të mbështetur mendimin tuaj. 4 pikë

PJESA II

Leximi i përbashkët

[Gjatë pushimeve, Marseli takohet me Izabelën, moshataren e vet. Një ditë vajza iu lut djalit të dëgjonte "historinë më të bukur në botë" atë të "Shitëses së vogël të shkrepëseve", që ajo do ta lexonte enkas për të. Marseli fillon të dëgjojë Izabelën.]

Që në rreshtin e parë të tregimit, bënte ftohtë, ishte errësirë, binte borë. Këto kushte të këqija atmosferike nuk kishin të bënin aspak me mua, që, përkundrazi, po kolovitesha nën hijen e vakët të një akacieje, buzë bokërimës plot diell.

Në rreshtin e pestë, e gjora fëmijë, që ishte me kokë të zbuluar, humbi shapkat nga hutimi dhe tashmë i duhej të "ecte mbi dëborë, me këmbët e zathura që i ishin skuqur e mavijosur nga të ftohtët."

Fillimisht mendova se ishte e pazonja të çalliste për vete, se prindërit e saj qenë kriminelë që e linin të dilte vetëm përjashta, mes borës dhe se ai që e tregonte këtë histori, përpiqej si e si të më bënte të ndieja keqardhje; nuk pranoja, pra, të ndieja dhe unë të ftohtë nga këmbët së bashku me të; mirëpo Izabela e kishte marrë me mjaft seriozitet dhe lexonte me këmbëngulje, si të kishte përpara një gazetë. Të bëhej sikur ajo kishte shumë zëra. Herë zë të ftohtë e monoton, si bora që binte, herë zë lakmues e të ngrohtë tek thoshte: "Tërë rruga ishte mbushur me erën e mishrave që piqeshin" dhe herë zë therrës nga zemërimi, kur djali i lig i vodhi shapkën e dytë të pafajshmes vajzë...

Fillimi që kur vogëlushja u përpoq të ngrohte "të shkretat duar të kallkanosura nga të ftohtët", duke ndezur "fijet e shkrepëses njëra pas tjetrës". Nuk kishte si të mos prekeshe nga kjo mënyrë krejt e kotë për t'u ngrohur dhe, tek e përfytyroja të zbehej e të mavijosej e tëra, u vura në merak të madh se si do t'i shkonte vallë filli heroinës sonë.

Magjia e shkaktuar nga flaka "magjepsëse" e atyre shkrepëseve (doemos suedeze) më ngushëlloi një çast, nxitur nga gëzimi i papritur i zërit të Izabelës, që i bënte një përshkrim të arrire këtyre përfytyrimeve të mrekullueshme dhe shfaqja e gjyshes më dha një ndjenjë sigurie, megjithëse m'u duk diçka e pashpjegueshme. Më në fund, kur të dyja, gjyshe e mbesë, mbërritën tek i miri Zot, ç'kënaqësi për mua që ai ishte i pranishëm për t'u dhënë lumturinë që u takonte. Po historia nuk mori fund me kaq!

Rrëfenjësi mizor bënte një zbulim të tmerrshëm në rreshtat e fundit. Izabela u mëshoi me një ton të ngadaltë, me një dhembshuri që ia dridhte, ia mbyste zërin dhe, kur ajo tha: "vdekur, vdekur nga të ftohtët, natën e fundit të vitit", nuk kishte si të vijonte më tej dhe lot të sumbullt i rrodhën përgjatë faqeve të zbehta.

Nuk arriti ta përmbante ngashërimin. Së fundi, mezi i doli zëri për të vijuar: "Dita e parë e vitit zbardhi mbi kufomën e vogël, nderur mbi tokë, mes shkrepëseve të saj të djegura!..."

Atëherë m'u bë sikur e vdekura e vogël ishte ajo vetë, Izabela. E pashë krejt të bardhë midis borës dhe u hodha nga hamaku* për t'i shkuar në ndihmë. Ajo më shmangu lehtë me dorë, duke më thënë me zë të mbytur:

- Prit!

Lexoi rreshtat e fundit: "Askush nuk i kishte njohur bukuritë që ajo kishte parë, as tërë ato vezullime mes të cilave ajo depërtoi tok me gjyshen e saj plakë atë natë të Vitit të Ri".

Këto vezullime as që mund të më ngushëllonin. Ajo kishte vdekur nga të ftohtët dhe kjo qe e tëra. Gjithçka tjetër ishte sa për sy e faqe dhe, tek e shihja Izabelën të çohet përpjetë në ajër, mbajtur për dore nga një plakë me flokë të bardhë, që ngrihej dhe ajo lart, lot të mëdhenj më rrokulliseshin faqeve dhe unë shtrëngoja fort gjoksin tim për ta mbajtur mbërthyer mbi tokë.

Mes lotëve, Izabela ia dha së qeshurës:

- Sa budalla që bëhesh! – foli ajo.- Përrallë është, asgjë e vërtetë. Si s'të vjen turp që qan kështu?

- Pse, ti s'po qan?

- Unë jam gocë. Pastaj, unë kam qejf të qaj edhe kur është për të qeshur. Kurse për një çun...

***hamak** – shtrat prej pëlhure, varur midis degëve të një peme.

6. Në fjalinë: "të shkretat duar të kallkanosura nga të ftohtët" fjala **të kallkanosura** ka kuptimin: **1 pikë**

- A) të çara; B) të lodhura;
C) të ngrira; D) të zbardhura.

7. Cila nga fjalitë e mëposhtme përshkruan lidhjen midis asaj çka ndodh në tregim dhe mënyrës se si tregimtari e rrëfen tregimin? **1 pikë**

- A) Ai tregon ngjarje të dhimbshme në mënyrë humoristike.
B) Ai tregon ngjarje të dhimbshme në mënyrë emocionuese.
C) Ai tregon ngjarje të përditshme në mënyrë sensacionale.
D) Ai tregon ngjarje të jashtëzakonshme me vërtetësi.

8. Çfarë mendon djali për përrallën që i tregon Izabela? **1 pikë**

- A) Është zhgënjyese dhe të mërzit.
B) Është prekëse dhe intriguese.
C) Është e ngarkuar me hollësi të tepërta.
D) Është e përshtatshme për fëmijët e moshës së tij.

9. Në cilën prej fjalive të mëposhtme gjuha merr një ngarkesë të theksuar emocionale? **1 pikë**

- A) Këto vezullime as që mund të më ngushëllonin.
B) Nuk kishe si të mos prekeshe nga kjo mënyrë krejt e kotë për t'u ngrohur.
C) Izabela e kishte marrë me mjaft seriozitet dhe lexonte me këmbëngulje.
D) ...dhe herë zë therës nga zemërimi, kur djali i lig i vodhi shapkën e dytë të pafajshmes vajzë...

10. Cila nga fjalitë e mëposhtme tregon se kjo histori është shkruar në vetën e parë? **1 pikë**

- A) Që në rreshtin e parë të tregimit, bënte ftohtë, ishte errësirë, binte borë.
B) Rrëfenjësi mizor bënte një zbulim të tmerrshëm në rreshtat e fundit.
C) Ajo kishte vdekur nga të ftohtët dhe kjo qe e tëra.
D) Atëherë m'u bë sikur e vdekura e vogël ishte ajo vetë, Izabela.

11. I gjithë **paragrafi i parë** i tregimit ngrihet mbi bazën e një kontrasti. Cili është ai? **1 pikë**

12.

- a. Shpjegoni se çfarë natyre është djali. Ku duket kjo? **2 pikë**
b. Djali dallohet për një imagjinatë të zhvilluar. Identifikoni **dy momentet** kur ajo shfaqet veçanërisht e tillë. **2 pikë**
c. Si reagon Izabela kur shikon djalin që qan? **1 pikë**

13.

- a. A mendoni se Izabela është një vajzë e ndjeshme apo një interpretuese shumë e talentuar? Argumentoni mendimin tuaj edhe me ilustrime nga tregimi. **3 pikë**
- b. Cili është mendimi juaj në lidhje me fjalët që vajza thotë në fund të këtij tregimi? Shpjegoni nëse jeni ose jo dakord me të. **2 pikë**
- c. Si mendoni, çfarë mund të ketë thënë djali për të mbrojtur veten e tij në mbyllje të tregimit? **1 pikë**
- d. Përgjatë tregimit hasim shpesh disa fjalë ose fjali, të cilat autori i ka futur midis thonjzave dhe që janë me shkronja të pjerrëta. Për ç'qëllim ai e bën këtë? **1 pikë**

PJESA III

14. Cila nga grupet e fjalëve është shprehje frazeologjike? 1 pikë
- A) mendova se ishte e pazonja; B) vdekur nga të ftohtët;
C) ishte sa për sy e faqe; D) plakë me flokë të bardhë.
15. Në fjalinë: *Ai përpiqej të më bënte të ndieja keqardhje* emri i nënvizuar është: 1 pikë
- A) në kallëzore të pashquar; B) në emërore të pashquar;
C) në kallëzore të shquar; D) në dhanore të shquar.
16. Në fjalinë: *E pashë krejt të bardhë midis borës dhe u hodha për të ndihmuar vajzën e gjorë* forma e pashtjelluar ka funksionin e: 1 pikë
- A) rrethanorit të shkakut; B) rrethanorit të qëllimit;
C) rrethanorit të mënyrës; D) përcaktorit.
17. Gjeni mbiemrin në këtë fjali dhe tregoni shkallën e tij. 2 pikë
- Izabelën e pashë krejt të bardhë midis borës dhe u hodha për t'i shkuar në ndihmë.*
18. Në fjalinë e mëposhtme gjeni një fjalë të përngjitur dhe thoni se cilës klase fjalësh i përket: 2 pikë
- Mirëpo Izabela e kishte marrë me mjaft seriozitet dhe lexonte me këmbëngulje.*
19. Ç'pjesë ligjërate janë fjalët e nënvizuara në fjalinë më poshtë? 2 pikë
- Atëherë m'u bë sikur këto kushte të këqija atmosferike nuk kishin të bënin me mua..*
20. Tregoni llojin e përemrit të nënvizuar në fjalinë e dhënë. 1 pikë
- Ajo m'u duk diçka e pakuptueshme për mua.*
21. Gjeni kryefjalën në këtë fjali: 1 pikë
- Mua as që mund të më ngushëllonin këto vezullime.*
22. Gjeni kallëzuesin e përbërë në fjalinë e dhënë: 1 pikë
- Ajo zuri të fliste ngadalë: "Tërë rruga ishte mbushur me erën e mishrave që po piqeshin".*
- 23.
- a. Gjeni një rrethanor në këtë fjali dhe tregoni llojin e tij. 2 pikë
- E pashë krejt të bardhë midis borës dhe u hodha ta ndihmoja, por ajo më shmangu lehtë me dorë.*
- b. Gjeni mënyrën dhe kohën e foljes së nënvizuar në fjalinë e mëposhme: 2 pikë
- ...vogëlushja u përpoq të ngrohte "të shkretat duar të kallkanosura nga të ftohtët"...*
24. **Qarkoni** fjalinë e përbërë dhe **tregoni** llojin e saj. 2 pikë
- A) Këto kushte të këqija atmosferike nuk kishin aspak lidhje me mua.
B) Izabela lexonte me këmbëngulje, sikur të kishte përpara një gazetë.
C) Magjia e shkaktuar nga flaka "magjepsëse" e atyre shkrepëseve më ngushëlloi një çast.
D) Unë u hodha me shpejtësi për t'i shkuar në ndihmë menjëherë.

25. **Të shkruajmë**

E gjithë jeta jonë ndikohet nga fuqia e fjalëve: gjëra që prindërit na kanë thënë, poezi apo këngë që kemi dëgjuar, rreshta nga një roman që kemi lexuar, thënie nga mësuesi apo shoku.

Shkruani një ese ku të **përshkruani** ndikimin që disa fjalë mund të kenë pasur te ju.

6 pikë